

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Metodologjia e Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)

Neni 1 Baza Ligjore

Kjo metodologji hartohet në përputhje me nenet 19/b; 47;79/4; 81/4; 83; 85 dhe 109 të Ligjit Nr. 43/ 2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, VKM Nr.244, datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të Shërbimit Publik që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” VKM Nr. 449, datë 15.06.2016 "Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike", nenet 21 dhe 22 të "Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Proçedurat e ERE-s" miratur me Vendimin Nr.96, datë 17.06.2016, Vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 112, datë 08.07.2016 "Për përcaktimin e të licensuarit të ngarkuar me detyrimin e Shërbimit Universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e Kushteve për ushtrimin e detyrimit të Shërbimit Universal”

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i kësaj metodologjie është përcaktimi i parimeve, rregullave dhe proçedurave për vendosjen e çmimeve me pakicë të energjisë elektrike, për klientët fundorë të cilët furnizohen nga FSHU.

Neni 3 Objekti

Kjo metodologji ka si objekt përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për kategoritë e mëposhtme të klientëve që furnizohen nga FSHU në zbatim të Ligjit 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" si dhe VKM Nr. 449, datë 15.06.2016

- Klientët e lidhur në rrjetin shpërndarjes 20 kV, 10 kV dhe 6 kV;
- Klientët e lidhur në rrjetin e shpërndarjes 0.4 kV deri në momentin që ERE të vendosë që këta klientë përfitues të shërbimit universal të mund ta blejnë energjinë elektrike në treg me çmime të parregulluara, sikurse kërkohet nga neni 9 i Kushteve për të licensuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 112, datë 08.07.2016.

Neni 4 Përkufizime

Termat e përdorur në këtë metodologji kanë të njëjtin kuptim si ai i përshkruar në Nenin 3 e në vazhdim të Ligjit Nr. 43/ 2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”. Termat e veçantë të përdorur në këtë metodologji kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. **Shërbim Universal i Furnizimit** – është një shërbim publik për furnizimin e klientëve fundorë, i cili siguron të drejtën e tyre për t'u furnizuar me energji elektrike të një cilësie të caktuar, brenda gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese.
2. **Borxh i Keq** – një vlerë e lejuar në të ardhurat e kërkuara të FSHU nga llogaria klientë, e cila nuk ka më shpresë arkëtimi.
3. **Shpenzimet e Amortizimit** – kostot e amortizimit të lidhura me aktivet afatgjata materiale që përdoren për ofrimin e shërbimit universal, si dhe kostot e amortizimit të lidhura me aktivet afatgjata jomateriale, si programet kompjuterike që përdor FSHU, siç përcaktohet në standartet e kontabilitetit në fuqi.
4. **Kostoja për energjinë dhe kapacitetin** - është kostoja që përballon FSHU për energjinë elektrike dhe kapacitetin që nevojitet për t'u shërbyer klientëve që plotësojnë kushtet për marrjen e shërbimit universal dhe që përfshin: (1) blerjet e energjisë elektrike nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës kontrollohen tërësisht ose pjesërisht nga shteti në përputhje me kushtet e kontratës vjetore ndërmjet palëve, të miratuar nga ERE, në përputhje me nenin 5.2 të VKM Nr. 244, datë 30.03.2016; (2) blerjet e energjisë elektrike në tregun e parregulluar përtej sasisë së kontraktuar me shoqërinë e prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës kontrollohen tërësisht ose pjesërisht nga shteti; (3) kostot e lidhura me pagesat për balancimin, si dhe çdo kosto tjetër që ka të bëjë me blerjen e energjisë elektrike dhe të kapacitetit; (4) kostot përkatëse të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burime të rinovueshme.
5. **Kostoja e përdorimit të sistemit të transmetimit** – vlera që do t'i paguhet Operatorit të Sistemit të Transmetimit për përdorimin e sistemit të transmetimit sipas tarifave të miratuara nga ERE.
6. **Kostoja e përdorimit të sistemit të shpërndarjes** – vlera që i paguhet OSSH-së për përdorimin e sistemit të shpërndarjes, sipas tarifave të miratuara nga ERE.
7. **EURIBOR** – norma e ofertës ndërbankare të Federatës Europiane të Bankave për depozitat me afat 3 muaj në Euro, siç tregohet në faqen përkatëse të Reuters në ose rreth orës 11:00 paradite sipas orës qëndrore Europiane (CET). Norma e përdorur do të jetë normë vjetore.

- 8. Kostot e mirëmbajtjes dhe të operimit** – kostot që përballon FSHU në lidhje me: (1) kostot direkte të mirëmbajtjes të lidhura me aktivitetin e FSHU; (2) kostot të përgjithshme dhe administrative të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetin e FSHU; (3) kostot e lidhura me pagesat e liçensimit dhe rregullimit të FSHU.
- 9. Periudhë Rregullatore** – periudha 12 mujore që përdoret nga rregullatori për të përcaktuar të ardhurat e kërkuara nga i liçensuari, me qëllim të përcaktimit të çmimeve.
- 10. Të ardhurat e kërkuara** – shuma e të ardhurave që i nevojitet një të liçensuari të mirëmenaxhuar për të kryer aktivitetin për të cilin është liçensuar, për periudhën rregullatore. Kjo sasi të ardhurash propozohet nga i liçensuari dhe miratohet nga rregullatori.
- 11. Marzhi i fitimit** – një përqindje fikse që aplikohet mbi kostot e blerjes së energjisë elektrike dhe kapacitetit nga ana e FSHU.
- 12. Kapitali i punës (WC)** –fondi i nevojshëm për të përballuar diferencën në kohë midis kryerjes së shpenzimit për sigurimin e shërbimit dhe vjeljes së të ardhurave nga klientët gjatë aktivitetit.
- 13. Shuma e lejuar për “Kapitalin e Punës” (WCA)** – vlera e lejuar që i jepet FSHU në të ardhurat e kërkuara për mbulimin e kostos së fondeve të huajtura që përdoren në aktivitetin e përditshëm.

Neni 5

Proçesi i rishikimit të çmimeve

1. Çmimet e shitjes me pakicë të FSHU rishikohen dhe miratohen mbi baza vjetore, siç përcaktohet në nenin 85 të Ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
2. Periudha rregullatore gjatë së cilës do të jenë në fuqi këto çmime do të jetë një parashikim për 12 muajt e ardhshëm.
3. Proçesi i përcaktimit të çmimeve kërkon që FSHU të paraqesë në ERE aplikimin për çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike tek klientët fundorë të shërbyer prej tij, me përmbajtje si më poshtë:
 - Një listë të të ardhurave dhe shpenzimeve aktuale të FSHU për 12 muajt e fundit, të përgatitura sipas standarteve të kontabilitetit në fuqi.
 - Të dhëna për energjinë elektrike të blerë nga FSHU (sipas burimit) dhe energjisë elektrike të shitur për çdo kategori klientesh për 12 muajt e fundit.
 - Parashikimin e energjisë elektrike që FSHU do të prokurojë për 12 muajt e ardhshëm për të përmbushur kërkesat e çdo kategorie klientësh që plotësojnë kushtet për t’u furnizuar nga FSHU.

- Parashikimin e të ardhurave të kërkuara të FSHU për periudhën rregullatore, objekt i shqyrtimit.
- Shpërndarja e të ardhurave të kërkuara për periudhën e parashikuar sipas kategorive të klientëve që furnizohen nga FSHU.
- Shpërndarja e kërkuar për strukturën e propozuar të çmimeve për të përfituar të ardhurat e kërkuara për çdo kategori çmimesh.

ERE shqyrton të dhënat dhe informacionin e paraqitur nga i licensuari, informacion i cili paraqitet në ERE në përputhje me nenin 21 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016 dhe shprehet nëse informacioni është apo jo i plotë. Në rast se të dhënat nuk janë të plota, ERE njofton të licensuarin për mangësitë duke i lënë atij një afat për të paraqitur informacionin shtesë apo të korrigjuar. Informacioni i paraqitur nga i licensuari vihet në dispozicion të publikut. ERE analizon informacionin e paraqitur nga i licensuari dhe jep opinion në lidhje me arsyeshmërinë, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e informacionit të paraqitur. Në rastet kur ERE nuk e gjen informacionin e dhënë të saktë ose të plotë do të shpjegojë arsyet për mosdakortësinë e saj dhe propozon vlera alternative të arësyeshme dhe të justifikuara.

4. Nëse FSHU nuk bie dakord me vendimin e ERE-s për tarifën, ai mund ta apelojë vendimin në Gjykatë sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
5. Çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët sipas nivelit të tensionit ku janë lidhur do të reflektojnë plotësisht kostot që ato shkaktojnë për marrjen e shërbimit të furnizimit me energji elektrike

Neni 6

Përcaktimi i të Ardhurave të Kërkuara

1. **Të ardhurat e kërkuara (RR)** të Furnizuesit Universal do të përbëhen nga elementët e mëposhtëm:

a. Kostoja për energjinë elektrike dhe kapacitetin

Kjo kategori përfshin kostot e energjisë elektrike dhe kapacitetit të nevojshëm për t’u shërbyer klientëve që plotësojnë kriteret për marrjen e shërbimit universal. Si i tillë ai përfshin:

- Energjinë elektrike të blerë nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës kontrollohen tërësisht apo pjesërisht nga shteti në përputhje me kushtet e kontratës vjetore ndërmjet palëve, miratuar nga ERE dhe me nenin 5.2 të VKM Nr. 244, datë 30.03.2016.
- Energjinë elektrike dhe kapacitetin e kërkuar përtej sasisë së vënë në dispozicion nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës

kontrollohen tërësisht apo pjesërisht nga shteti, në përputhje me rregullat e tregut.

- Kostot e lidhura me disbalancat përkatëse si dhe çdo lloj kostoje tjetër që ka të bëjë me sigurimin e energjisë elektrike dhe kapacitetit që kërkohet.
- Pagesa e tarifës për operatorin e tregut në përputhje me rregullat e tregut dhe/apo ato të Bursës Shqiptare të Energjisë (BSHE).

b. Kostot e transmetimit

Kjo kategori përfshin shumat që do t'i paguhen Operatorit të Sistemit të Transmetimit për përdorimin e rrjetit të transmetimit sipas tarifës së miratuar nga ERE.

c. Kostot e shpërndarjes

Kjo kategori përfshin shumat që do t'i paguhen Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për përdorimin e sistemit të shpërndarjes, sipas tarifave të miratuara nga ERE.

d. Kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes

Kjo kategori përfshin kostot direkte të operimit dhe mirëmbajtjes të FSHU si dhe kostot të përgjithshme dhe administrative të lidhura drejtpërdrejt me funksionimin e FSHU sipas standarteve të kontabilitetit në fuqi. Çdo kosto licënsimi dhe rregullimi e FSHU do të përfshihet në këtë kategori.

Kostot e lidhura me ndërgjegjësimin publik që kanë të bëjnë me sigurimin teknik, inkurajimin e klientëve për pagimin e faturave të energjisë elektrike në kohë si dhe dekurajimin e klientëve për përdorimin e metodave abuzive në konsumin e energjisë elektrike do të përfshihen në kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes.

Kostot e publicitetit apo çdo formë tjetër marketingu me qëllim inkurajimin e rritjes së konsumit nuk do të lejohen të përfshihen në kostot e operimit dhe mirëmbajtjes.

e. Shpenzimet e amortizimit

Janë kostot e amortizimit të lidhura me aktivet afatgjata materiale që shërbejnë për sigurimin e shërbimit universal siç përcaktohet në standartet e kontabilitetit. Në këtë kategori do të përfshihet gjithashtu çdo kosto amortizimi që ka të bëjë me aktivet afatgjata jomateriale të tilla si programet kompjuterike, që përdoren nga FSHU.

f. Marzhi i fitimit

Marzhi i fitimit do të jetë një përqindje fikse që aplikohet mbi kostot për blerjen e energjisë elektrike dhe kapacitetit. Niveli i marzhit të fitimit do të përcaktohet i tillë që t'i mundësojë FSHU-së një fitim të arësyeshem që kompenson riskun që i

licensuari merr për ofrimin e këtij shërbimi ndaj klientëve që e përfitojnë atë. Ky marzh do të përcaktohet duke patur parasysh marzhet e përfituara nga shoqëri të ngjashme në rajon, duke marrë në konsideratë ngjashmërinë ndërmjet industrisë së energjisë elektrike të atyre vendeve me Shqipërinë por jo më shumë se 3%.

ERE-s mund të të vendosë më tej për ndonjë axhustim të nevojshëm, aty ku ndryshimet janë sinjifikative. Marzhi i fitimit (**RM**) llogaritet si më poshtë:

$$\mathbf{RM = E \times (\%) e lejuar}$$

ku E është kostoja për blerjen e energjisë dhe kapacitetit

g. Vlera e lejuar për “kapitalin e punës” (WCA)

Baza për përcaktimin e vlerës së lejuar të kapitalit të punës do të jetë 1/12 e shumave të elementeve të lejuar si më poshtë:

- Kosto e energjisë elektrike dhe kapacitetit (**E**)
- Kosto shërbimit të transmetimit dhe të shpërndarjes (**TF + DUOS**)
- Kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes (**OM**)

Formula e llogaritjes së kapitalit të punës është si më poshtë:

$$\mathbf{WC = \frac{1}{12} * (E + TF + DUOS + OM)}$$

Kostoja e financimit të kapitali të punës do të bazohet në kostot e borxhit afatshkurtër të të licensuarit. Në rast se një vlerë e tillë nuk mund të përcaktohet, do të aplikohet një normë e njëjtë me EURIBOR si dhe një përqindje shtesë prej x%. Kjo përqindje shtesë (x) do të bazohet në situatën e tregjeve rajonale financiare në momentin e përcaktimit. Me qëllim të rishikimit të tarifave për herë të parë, kjo shtesë do të jetë në nivelin 3% të vlerës.

Vlera e lejuar për “kapitalin e punës” llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$\mathbf{WCA = WC \times WCC}$$

ku:

WCA- vlera e lejuar e kapitalit të punës

WC - kapitali i punës

WCC- kostoja e financimit të kapitalit të punës

h. Borxhi i keq

Borxhi i keq do të jetë vlera e lejuar në të ardhurat e kërkuara (RR). I licensuari (Shoqëria) do të propozojë një vlerë për borxhin e keq, të cilën ERE do të duhet ta vlerësojë nëse është e arësyeshme.

Për menaxhimin me efektivitet të llogarive të arkëtueshme nga ana e FSHU, ERE mund të vendosë një objektiv rregullator për borxhin e keq për t'i dhënë Shoqërisë nxitje për uljen e këtij niveli, krahasuar me atë të vitit paraardhës.

i. Korigjimi i të ardhurave të realizuara mbi/nën kërkesën e lejuar për të ardhura për vitin paraardhës (AXH)

Në rast se i licensuari, gjatë vitit parardhës ka realizuar më shumë apo më pak të ardhura të kërkuara se ato të lejuara, ato do të korrigjohen për rastet e mëposhtme:

- Diferencat në sasinë e energjisë elektrike të parashikuar dhe asaj të faturuar;
- Diferencat për kostot e parashikuara dhe ato të realizuara të energjisë elektrike dhe kapacitetit në çmimin për njësi (kWh);
- Diferencat ndërmjet kostove të parashikuara për njësi dhe atyre të realizuara të transmetimit dhe shpërndarjes;
- Diferencat që vijnë nga një strukturë shitjeje e realizuar e ndryshme nga ajo e miratuar;
- Pagesës së bërë nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës kontrollohen tërësisht ose pjesërisht nga shteti në përputhje me nenin 5.3 të VKM Nr. 244, datë 30.03.2016.

2. Kërkesa për të Ardhura (RR) e FSHU llogaritet sipas formulës më poshtë:

$$RR = E + TF + DUOS + OM + DA + RM + WCA + BD + AXH$$

Ku:

E	<i>kostoja përblerjen e energjisë elektrike dhe kapacitetit</i>
TF	<i>kostoja për përdorimin e sistemit të transmetimit</i>
DUOS	<i>kostoja për përdorimin e sistemit të shpërndarjes</i>
OM	<i>kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes</i>
DA	<i>kosto e amortizimit të aseteve</i>
RM	<i>marzhi i fitimit</i>
WCA	<i>vlera e kostos së financimit të kapitalit të punës</i>
BD	<i>borxhi i keq</i>
AXH	<i>korigjimi i të ardhurave të realizuara mbi/nën kërkesën e lejuar për të ardhura për vitin paraardhës</i>

Neni 7

Ndarja e të ardhurave të kërkuara sipas strukturës së çmimeve

1. Të ardhurat e kërkuara të përcaktuara sipas nenit 4, duhet të ndahen sipas strukturës së çmimeve duke përdorur parimet bazë si më poshtë:

- a. Kostot e energjisë elektrike dhe kapacitetit do të ndahen sipas kategorive të klientëve bazuar në grafikun e ngarkesës duke reflektuar kohën e përdorimit, përfshirë modelet sezonale të konsumit në periudhën e pikut dhe atë jashtë saj për secilën kategori klientësh.
- b. Pagesat e përdorimit të sistemit të shpërndarjes do të ndahen për çdo kategori klientësh bazuar në nivelin e tensionit në të cilin ofrohet shërbimi.
- c. Pagesat e përdorimit të sistemit të transmetimit do të caktohen sipas kategorive të klientëve bazuar në përqindjen e kWh që përdoren nga secila kategori klientësh.
- d. Vlera e kapitalit të punës do t'u shpërndahet kategorive të klientëve bazuar në pjesën që i takon çdo kategorie klientësh të përmendur në paragrafet a, b dhe c.
- e. Shpenzimet e operimit dhe të mirëmbajtjes, shpenzimet e amortizimit si dhe marzhi i fitimit do të shpërndahen sipas kategorive të klientëve bazuar në përqindjet e energjisë së shitur për çdo kategori.
- f. Shpenzimi për borxhin e keq do të llogaritet për çdo kategori klientësh bazuar në përqindjen e borxhit të keq të 12 muajve të fundit, të korrigjuar me një koeficient inkurajimi të vendosur nga ERE.
- g. Korrigjimi i të ardhurave të realizuara mbi/nën kërkesën e lejuar për të ardhura për vitin paraardhës, do të shpërndahet sipas kategorive të klientëve bazuar në përqindjet e shitjeve në kWh.

Neni 8

Përcaktimi i çmimeve për secilën kategori klientësh

1. Të ardhurat e kërkuara për çdo kategori klientësh, të përcaktuara sipas nenit 5, do të krahasohen me të ardhurat e pritshme bazuar në nivelin aktual të çmimeve për çdo kategori klientësh. Tepricat apo mungesat do të identifikohen për secilën nga kategoritë.
2. I licensuari do të shqyrtojë elementët aktuale të faturimit për secilën kategori të çmimeve dhe do të propozojë ndryshime të këtyre elementëve që mund të përfshijnë (në varësi të kategorisë së konsumatorëve apo aftësisë matëse):
 - Tarifën mujore fikse
 - Tarifën e energjisë (Lekë/kWh)
 - Tarifën për kapacitetin (Lekë/kWh)
 - Çmimin për energjinë reaktive (lekë/kVarh)
 - Të tjera
3. I licensuari do të propozojë çmime të reja për çdo kategori klientësh me qëllim që të mbledhi të ardhurat e kërkuara për secilën nga kategoritë e klientëve.

ERE do të shqyrtojë propozimin e të licensuarit dhe do të bëjë ndryshimet që i gjykon të nevojshme me qëllim që deri në 31.12.2017 të miratojë tarifa që reflektojnë plotësisht kostot për çdo kategori klientësh, në mënyrë që t'i mundësojë ata të dalin në tregun e liberalizuar,

ashtu siç përcaktohet në nenin 109 të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në nenin 9 të kushteve për të liçensuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike në Shqipëri të miratuar me Vendimin Nr. 112, datë 08.07.2016 të Bordit të ERE-s.

Neni 9 Miratimi

Kjo metodologji u miratua me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.189, datë 23.11.2017.